



# STIKK

SHOQATA PËR TEKNOLOGJI TË INFORMACIONIT  
DHE TË KOMUNIKIMIT TË KOSOVËS

KOSOVO ASSOCIATION OF INFORMATION  
AND COMMUNICATION TECHNOLOGY

---

# Aplikimi i normave të reduktuara të TVSH-së për disa produkte dhe shërbime të TIK

## Ndikimi socio-ekonomik për Kosovën

---

**Dokument Politikash**

Përgatitur nga Artan Xërxa

Prishtinë, Qershor 2013

## Lista e Shkurtesave

<b>BiP</b>	Bilanci i Pagesave
<b>BE</b>	Bashkimi Evropian
<b>IJD</b>	Investimet e Jashtme Direkte
<b>IRJM</b>	Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë
<b>TIK</b>	Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit
<b>OBEZH</b>	Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim
<b>MSA</b>	Marrëveshje e Stabilizim Asociimit
<b>STIKK</b>	Shoqata për Teknologji të Informacionit dhe të Komunikimit të Kosovës
<b>ATK</b>	Administrata Tatimore e Kosovës
<b>TVSH</b>	Tatimi mbi Vlerën e Shtuar
<b>BP</b>	Ballkani Perëndimor



## Përmbajtja

Lista e Shkurtesave.....	2
I. Hyrje.....	4
II. Zhvillimi i Sektorit të TIK-ut në Kosovë dhe Normat e TVSH-së .....	6
III. Kuadri Ligjor i BE-së.....	8
IV. Shqyrtimi i Praktikave Më të Mira – Disa vende të Ballkanit Perëndimor & Turqia (Shqipëria, IRJM, Serbia, Turqia) .....	9
a. Shqipëria .....	10
b. IRJ e Maqedonisë.....	11
c. Serbia .....	11
d. Turqia.....	12
V. Ndikimi Financiar në Buxhetin e Kosovës.....	13
VI. Rekomandimet.....	14
a. Që kanë të bëjnë me TVSH-në.....	14
b. Masat e Politikave Fiskale të Përgjithshme .....	15



## I. Hyrje

Ky dokument bën vlerësimin e efekteve të mundshme socio-ekonomike të një aplikimi eventual të normës së reduktuar të TVSH-së për pajisjet dhe shërbimet e TIK në Kosovë, bazuar në praktikën dhe standardet më të mira të aplikuara në disa vende të Ballkanit Perëndimor dhe BE-së. Ndër të tjera analiza përfshin efektet në çmime, shitje, ekonominë informale, edukimin dhe punësimin. Studimi për Kosovën është bërë nga STIKK duke përdorur shërbimet e një konsulenti të pavarur i cili u takua me disa menaxherë dhe pronarë të bizneseve të industrisë së TIK-ut dhe gjithashtu ndërmori një hulumtim të tregut lidhur me këtë temë.

TVSH, si tatim indirekt, pretendohet të bartet nga përdoruesi – në këtë rast "konsumatori" i një malli apo një shërbimi. Që nga paslufta d.m.th që nga viti 1999 Kosova ka aplikuar një normë të përgjithshme të sheshtë prej 16% TVSH, të aplikueshme për të gjitha mallrat dhe shërbimet që tregtohen brenda dhe jashtë saj, duke përfshirë importet dhe eksportet. Duke pasur parasysh disa zhvillimet e fundit në këtë fushë në disa vende fqinje (respektivisht në Maqedoni, Shqipëri dhe Serbi), Kosova ka mbetur prapa në këtë drejtim. Për këtë arsye, një shkallëzim apo zvogëlim eventual i TVSH-së për produkte apo shërbime të caktuara konsiderohet i rëndësishëm për të nxitur zhvillimin ekonomik në përgjithësi dhe do të kishte efekte pozitive shumëdimensionale. Në veçanti, ky stimul do t'i jepte mbështetje të drejtpërdrejtë industrisë në rritje të TIK në Kosovë – i cili konsiderohet si një sektor i pjekur me shumë mundësi të tjera për zhvillim, gjenerim të punësimit dhe si rrjedhojë do të kontribuonte në buxhetin e shtetit nëpërmjet rezultateve që do të prodhonte.

Në vitin 2012, të ardhurat nga TVSH-ja si përqindje e të ardhurave të përgjithshme të Buxhetit të ATK-së kanë përbërë 45,78% të totalit të të ardhurave nga taksat<sup>1</sup>. Shkallëzimi eventual i normës së TVSH-së do të kishte një efekt pozitiv në ekonomi duke ndikuar në: **rënien e çmimeve, rritjen e kërkesës/konsumit/cilësisë, si dhe zvogëlimin e ekonomisë informale**, duke gjeneruar kështu të ardhura shtesë për buxhetin e Kosovës në disa segmente të të ardhurave tatimore, që do të vinin në mënyrë indirekte nga: **gjenerimi i punësimit – si rrjedhojë e rritjes së kërkesës dhe tatimi mbi fitimin – si rrjedhojë e rritjes së qarkullimit të kompanive**. Kjo masë do të ishte e rëndësishme së madhe për bizneset e vogla dhe ç'është më e rëndësishmja për popullatën e re në Kosovë (më shumë se 50% janë të moshës 0-25 vjet) e cila zakonisht ka një buxhet të moderuar për pajisjet e TIK ndonëse ekziston një potencial i madh për përfshirjen e tyre aktive në industrinë e TIK-ut dhe në përgjithësi ata do të jenë të pajisur me produkte të teknologjisë së fundit dhe të cilësisë së mirë. *Më e rëndësishmja, buxheti i tyre i dedikuar për pajisjet e TIK-ut do të shpenzohej brenda Kosovës.*

Shumë qytetarë të Kosovës individualisht blejnë kompjuterë dhe pajisje tjera të TIK-ut në Shkup, IRJM, për shkak të çmimeve më të ulëta pikërisht si pasojë e uljes së fundit të TVSH-së për pajisjet e TIK-ut në këtë vend fqinj nga **18% në 5%** → që përbën të paktën rreth **11%** zbritje vetëm me dallim në TVSH kundrejt pajisjeve të blera në Kosovë. Përveç kësaj, pajisjet e TIK-ut importohen lehtë me detyrime doganore të favorshme nga IRJM, që e përmirëson pazarin për blerësit individual të Kosovës që është vetëm pak kilometra larg prej këtij vendi, dhe kjo në një shkallë prej 15-20% të çmimit të shitjes duke përfshirë edhe TVSH-në.

Për këtë arsye, kompanitë e TIK-ut që merren kryesisht me shitjen e harduerit po kanë vështirësi (kjo ndikon edhe në kompanitë që merren me zhvillimin e softuerit dhe me shërbime), ndërsa kjo ka ndikim negativ edhe


<sup>1</sup> Burimi – Administrata Tatimore e Kosovës (ATK) Raporti Vjetor 2012 – faqe 7 – Tabela 1 (në dispozicion vetëm në gjuhën Shqipe) <http://www.atk-ks.org/wp-content/uploads/2013/02/Raporti-Janar-Dhjetor-2012-07-02-2013-PDF.pdf>

në Bilancin e Pagesave (BiP) në Kosovë, pasi shuma të konsiderueshme të parave të gatshme të dedikuara për blerje të pajisjeve të TIK-ut janë duke u devijuar nga ekonomia e brendshme. Në rast të një ulje të TVSH-së, çmimet e pajisjeve të TIK-ut do të bijnë dhe të gjitha këto burime financiare do të kanalizoheshin brenda vendit, duke kontribuar në qarkullimin më të lartë të kompanive të TIK-ut dhe në të ardhura më të mëdha në Buxhetin e Kosovës nga taksat (TVSH dhe tatimi në fitim) dhe nga gjenerimi i punësimit (kontributet direkte nga punonjësit/punëdhënësit). Ky fakt i fundit do të zbuste ndonjë ulje fillestare të mundshme të të ardhurave nga TVSH-ja për ATK-në, ndërsa stimujt/ulja e TVSH-së për pajisjet e TIK-ut shumë shpejt do të rrisë kërkesën në mesin popullatës së re në Kosovë.


Për momentin sektori i TIK-ut në Kosovë po përparon në mënyrë solide, por ka nevojë për **mbështetje shtesë nga Qeveria përmes disa stimujve, të tilla si tarifat Doganore, dhe shkallëzimi i TVSH-së**. Në anën tjetër, ekziston nevoja për rritjen e kapaciteteve lokale lidhur me furnizimin me internet, trajnime/edukime dhe konsultime të specializuara në TI, dhe specializime në zhvillimin e softuerit, duke përfshirë programe specifike në kuadër të sistemit arsimor, në mënyrë që të përgatiten të rinjtë e Kosovës të interesuar në fushën e TIK-ut që të jenë më mirë të pajisur me kualifikimet/çertifikimet e nevojshme për të qenë konkurrent në rajon. Sa i përket tregut dhe sigurisë e stabilitetit të investimeve, është e rëndësishme të theksohet se disa nga kompanitë më të mëdha ndërkombëtare të TIK, të tilla si Microsoft, HP, IBM dhe Cisco, kanë gjetur tashmë partnerët e tyre në mesin e kompanive të TIK-ut në Kosovë. Në rrugën e saj drejt integritimit në BE, Kosova ka liberalizuar formalisht rrjetin dhe shërbimet e saj të TIK-ut nëpërmjet Ligjit mbi Telekomunikacionin nga Maji i vitit 2003. Përveç kësaj, këto shërbime mund të liberalizohen edhe më tej gjatë negociatave të pritura për MSA-në ndërmjet Kosovës dhe BE-së.

Në dhjetë vitet e fundit numri i përdoruesve të internetit dhe shërbimeve të TI është rritur me shpejtësi. Teknologjia e harduerit që përdoret në sektorin privat është e bazuar kryesisht në CISCO, IBM, Huawei, NERA, Iskra Transmission, Airspan, Motorola, Tsunami, etj. Sistemet e softuerit kryesisht bazohen në platformat Microsoft dhe Linux.

Një ilustrim në lidhje me strukturën, punësimin dhe madhësinë e kompanive të TIK-ut është pasqyruar në tabelat 1 dhe 2 të paraqitura më poshtë.



**Tabela 1:** Struktura e tregut të TIK në Kosovë



**Tabela 2:** Punësimi dhe Madhësia e Kompanive të TIK në Kosovë<sup>2</sup>

Kështu, më shumë se një e pesta e kompanive në treg kanë zgjedhur shitjen e harduerit dhe softuerit si veprimtari të tyre kryesore të biznesit, një e pesta tjetër merret me zhvillimin e softuerit dhe me programim. Mirëmbajtja dhe riparimi, shërbime të konsultimit dhe inxhinierike janë ndër aktivitetet kryesore sekondare të biznesit të kompanive të TIK në Kosovë. Shumica e kompanive të TIK janë duke synuar zgjerimin e tyre kryesisht në nivel lokal. Megjithatë një e treta e kompanive janë të orientuara drejt zgjerimit në vendet fqinje, dhe më pak se 20% janë duke kërkuar mundësitë për zhvillim në Evropë ose në Azi dhe SHBA<sup>3</sup>.

## II. Zhvillimi i Sektorit të TIK-ut në Kosovë dhe Normat e TVSH-së

Zhvillimi i sektorit të TIK-ut në Kosovë ka ndikim të madh në: (i) përmirësimin e ambientit të biznesit në Kosovë, si dhe në produktivitetin e numrit të madh të kompanive që punësojnë një numër të konsiderueshëm të rinjve, (ii) krijimin e mundësive për transformimin e ekonomisë së Kosovës në një ekonomi moderne të bazuar në dije, (iii) eksportimin e shërbimeve nga Kosova, përkatësisht në fushën e zhvillimit dhe testimit të softuerit, menaxhimin e rrjetit, qendrave të thirrjes, etj; (iv) zhvillimin e zgjidhjeve lokale në fushën e TIK-ut, të cilat ndihmojnë në përmirësimin e cilësisë së jetës së qytetarëve të Kosovës përmes platformave të sponsorizuara nga Qeveria (e-Shëndetësia, e-Qeveria, e-Arsimi, e-Teknologjia.); (v) rritjen e produktivitetit të përgjithshëm dhe lehtësimin e qasjes në informacion në fushat e shëndetësisë, shërbimeve sociale dhe arsimit në të gjitha nivelet; (vi) mbajtjen e përdoruesve në Kosovë të përditësuar me teknologjitë, trendet dhe mundësitë e reja në këtë fushë.

Të gjitha aktivitetet kryesore sektorale të përmendura më lart, ndër të tjera, përbëjnë një **potencial të madh për zhvillim, gjenerim të punësimit dhe mundësi për të rinjtë e papunë** – duke gjeneruar të ardhura indirekte për buxhetin e Kosovës nëpërmjet kontributeve të ndryshme të gjeneruara nga brenda dhe pagesës së tatimeve (krijimi i kompanive dhe punësimi).

<sup>2</sup> Burimi “[TIK në Kosovë – një sektor i dekoduar](#)” (PDF). Programi për Ndërmarrje Private në Kosovë (PNPK). 2010

<sup>3</sup> Burimi - [http://www.rciproject.com/itprofiles\\_files/ICT\\_Country\\_Profile-Kosovo.pdf](http://www.rciproject.com/itprofiles_files/ICT_Country_Profile-Kosovo.pdf)



Gjatë pesë viteve të fundit, sektori i TIK në Kosovë ka shënuar ngritje të normës mesatare vjetore të rritjes në të ardhurat e tij, ndërkohë që norma mesatare e rritjes vjetore të tatimit mbi vlerën e shtuar në këtë sektor dhe numri i të punësuarve po ashtu kanë shënuar përmirësime, por ende ekziston nevoja për kapacitete lokale në lidhje me infrastrukturën e TI, furnizimit me internet, trajnime dhe çertifikime të specializuara të TIK, zhvillimi dhe testimi i programeve, duke përfshirë tregtimin e shërbimeve me vendet e jashtme.

Legjislacioni tatimor në mënyrë eksplicite parasheh se në çfarë kushte dhe në çfarë raste personat e tatueshëm që janë sipërmarrës janë të detyruar të regjistrohen në TVSH. Përfshirja në ose largimi nga sistemi varet nga niveli i qarkullimit të realizuar në një periudhë të tatueshme të caktuar (zakonisht një vit), i ashtuquajtur i pragu i regjistrimit për TVSH. Sipërmarrësit që janë pjesë e sistemit të TVSH-së janë të detyruar të aplikojnë TVSH-në në të gjitha furnizimet e mallrave dhe shërbimeve, por kanë gjithashtu të drejtë të heqin TVSH-në e deklaruar në faturat e tyre të hyrjeve për mallrat dhe shërbimet e blera. Sipërmarrësit që nuk kualifikohen për regjistrim në TVSH për shkak të qarkullimeve të tyre të ulëta, nuk deklarojnë TVSH-në në faturat e dërgesave të tyre, dhe ata nuk lejohen të heqin TVSH-në e paguar për blerjet e mallrave dhe shërbimeve.

Legjislacioni i Kosovës për politikën e TVSH-së, ashtu si në fushat tjera, në shumicën e rasteve është hartuar në bazë të standardeve ndërkombëtare dhe të BE-së.

Sipas ligjit, Ministri i Ekonomisë dhe Financave, pas marrjes së vendimit nga Qeveria e Kosovës dhe pas miratimit në Kuvend, mund të nxjerr një akt nënligjor për aplikimin e një **norme të reduktuar të TVSH-së jo më të ulët se pesë për qind (5%) për furnizimet e caktuara të mallrave dhe shërbimeve**. Duke kaluar nëpër procedurë të njëjtë dhe sipas nevojës, Ministri mund të vendosë për aplikimin e një norme të përkohshme më të lartë të TVSH-së jo më të lartë se njëzet e një për qind (21%) që do të aplikohet ndaj furnizimeve të caktuara të mallrave dhe shërbimeve. Normat e reduktuara dhe të rritura mund të zbatohen vetëm për furnizimet e mallrave dhe shërbimeve të listuara në Aneksin III.<sup>4</sup> **Prandaj, është shumë e nevojshme që të përfshihen në këtë listë dhe në mënyrë efektive të aplikohet ulja e TVSH-së për pajisjet e TIK, duke përfshirë shërbimet e ndërlidhura me to.** Përveç kësaj, do të ishte mirë që të ulet TVSH-ja në disa përbërës bazikë ushqimorë dhe produkte përfundimtare, të njohur si "shporta bazë ushqimore".

Me uljen e normave të TVSH-së për produkte dhe shërbime të caktuara të TIK, bizneset që veprojnë në industrinë e TIK do të inkurajohen të **rrisin numrin e të punësuarve, kryesisht me punësimin e individëve të rinj e dinamik dhe kështu do të ulin papunësinë në përgjithësi dhe në veçanti tek të rinjtë – e cila është akoma më e larta në rajon.** Një sistem i thjeshtë, më transparent i TVSH-së, do t'i lironte bizneset nga ngarkesat e konsiderueshme administrative dhe do të inkurajonte tregtinë më të madhe ndërkufitare të mallrave dhe shërbimeve. **Kjo, në anën tjetër do të kontribuojë në zhvillim të qëndrueshëm ekonomik dhe do të gjenerojë më tepër të ardhura nga brenda të përmendura më parë, duke zbutur kështu uljen fillestare të të ardhurave nga TVSH-ja në buxhetin e shtetit, për shkak të reduktimit të normës së saj.**

<sup>4</sup> Shih Nenin 26 të Ligjit 03/146 për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar dhe faqe 75 për Aneksin III  
<http://www.assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/2009-146-eng.pdf>



### III. Kuadri Ligjor i BE-së

Gjithashtu është mirë që shkurtimisht t'i përmendim disa nga veçoritë kryesore të sistemit të BE-së për TVSH-në dhe qasjen ndaj normave të reduktuara të TVSH-së me futjen e tyre në kuadrin ligjor dhe funksionimin e përgjithshëm të TVSH-së së BE-së. Kjo është shumë e rëndësishme edhe për Kosovën, si vend kandidat potencial për anëtarësim në Bashkimin Evropian.

TVSH-ja në BE është e rregulluar përmes një udhëzimi<sup>5</sup> të këshillit dhe amendamentimit të tij të fundit<sup>6</sup>. Për çdo ndryshim të regjimit të TVSH-së duhet një vendim unanim nga 27 sekretarët shtetërorë të financave. Udhëzimi për TVSH-në është një instrument ligjor i BE-së. Udhëzimet janë të detyrueshme dhe duhet të implementohen në legjislacionet e brendshme të shteteve anëtare. Megjithatë, çdo shtet mund të zgjedhë mënyrën e implementimit.

Për të ndjekur frymën e Udhëzimit të 6-të, normat e reduktuara (dhe në përgjithësi të gjitha normat jo-standarde) duhet të mbesin si përjashtime nga norma standarde. Prandaj, ne konsiderojmë se norma standarde e TVSH-së duhet të mbulojë një gamë të gjerë të bazës së tatueshme TVSH-së. Me fjalë tjera, ne presim që shumica e transaksioneve që i nënshtrohen TVSH-së të taten me normë standarde. Megjithatë rregulli i përjashtimit duhet të vlejë edhe për mallrat dhe shërbimet e TIK. **Këto norma nuk duhet të jenë më pak se 5% dhe duhet të vlejë vetëm për furnizimet e kategorive të mallrave dhe shërbimeve të TIK.**

Një **Agjendë Digjitale për Evropën**<sup>7</sup> është dokumenti më i fundit strategjik udhëzues, i cili informon për dhe thekson hapat e rëndësishme duke përfshirë edhe ndryshimet e Udhëzimeve për TVSH-në (ftn's 5, 6) të cilat çdo vend anëtar duhet t'i zbatojë në mënyrë që të përmirësojë dhe nxisë online transaksionet dhe shërbimet më të mira ndërkufitare të TIK-ut. Disa nga veprimet e përshkruara mund të jenë të dobishme edhe për industrinë e TIK në Kosovë dhe perspektivën e zhvillimit të strategjisë e cila do të rreshtojë Kosovën me akterët kryesorë të Bashkimit Evropian, duke rritur kështu bashkëpunimin e ndërsjellë dhe potencialin për tregtimin e shërbimeve në këtë fushë.

---

<sup>5</sup> 2006/112/EC (udhëzimi për TVSH-në) i datës 28 Nëntor 2006, për sistemin e përbashkët të tatimit mbi vlerën e shtuar <http://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=OJ:L:2006:347:0001:0118:en:PDF>

<sup>6</sup> 2009/47 i datës 5 Maj 2009 – Amendamentimi i Udhëzimit 2006/112 mbi sistemin e përbashkët të TVSH-së <http://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=OJ:L:2009:116:0018:0020:EN:PDF>

<sup>7</sup> Një Agjendë Digjitale për Evropën

<http://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=COM:2010:0245:FIN:EN:PDF>




#### IV. Shqyrtimi i Praktikave Më të Mira – Disa vende të Ballkanit Perëndimor & Turqia (Shqipëria, IRJM, Serbia, Turqia)

Për shkak të pasigurisë aktuale ekonomike në shumë vende, shumica e reagimeve të qeverive<sup>8</sup> ndaj krizës ekonomike përfshijnë masat që synojnë sektorin e TIK-ut dhe promovimin e inovacionit të bazuar në TIK, përhapjen dhe përdorimin e tij. Për të nxitur rekuperimin, tre të katërtat e qeverive kanë rritur prioritetin e të paktën një fushe të politikave të TIK-ut. Theksi i politikave në kohën e fundit është vënë mbi fushat që kontribuojnë drejtpërsëdrejti në zhvillimin afatshkurtër dhe afatgjatë – vende pune në TIK, broadband, R&D dhe sipërmarrje në financa, dhe TIK të mençura për mjedisin – dhe kjo ofron dëshmi për rolin kyç që politikatat e TIK mund dhe duhet të luajnë.

Teknologjitë digjitale janë elementi qendror i strukturës në shoqërinë e sotme, dhe të qenit në gjendje t'i përdorim ato si duhet konsiderohet një aftësi jetike për çdo qytetar të shekullit të 21-të. Potenciali i padiskutueshëm i saj në sektorë të ndryshëm të aktiviteteve profesionale e bën teknologjinë një mjet të fuqishëm për zgjidhjen e problemeve ekonomike dhe shoqërore dhe, në fund të fundit, për rritjen e cilësisë së kushteve të jetës njerëzore.

Punësimi në TIK dhe punësimi i ndërlidhur me TIK përbëjnë një pjesë të konsiderueshme të punësimit total. Sektori i ICT kishte afër 6% të totalit të OBEZH punësimit në sektorin e biznesit në vitin 2010 dhe zhvillimi afatgjatë ka qenë disi më i shpejtë se sa për biznesin në përgjithësi. Ky trend është në rritje për shkak të zhvillimit të shpejtë të industrisë mobile dhe shërbimeve të ndërlidhura me të.

Tabela e mëposhtme ilustron këtë trend.



**Tabela 3:** OBEZH Treguesit Kryesorë të TIK (burimi OBEZH Perspektiva e TI 2010)  
 Përqindja e përdoruesve specialistë të TIK në ekonominë totale, 1995 dhe 2010

<sup>8</sup> Burimi – OBEZH Perspektiva e TI 2010 – Pikat Kryesore <http://www.oecd.org/sti/ieconomy/46444955.pdf>

Kosova ende nuk është ende anëtare e OBEZH, ndërsa është vlerësuar se vendi ka të paktën nivelin e punësimit të barabartë me IRJM ose më të lartë duke marrë parasysh numrin më të madh të popullatës së re dhe disa kompani specifike të TIK që bazohen në shërbime, respektivisht kompani që janë zhvilluar dhe themeluar kohët e fundit në Kosovë – Qendrat e Thirrjes.

Më poshtë, është një përmbledhje specifike e praktikave më të mira që kanë të bëjnë me shkallëzimin e TVSH-së në disa vende të Ballkanit Perëndimor dhe në Turqi.

## **A. SHQIPËRIA**

---

Në vitet e fundit Shqipëria ka ndërmarrë hapa të rëndësishëm për përmirësimin e mjedisit socio-ekonomik dhe klimës së biznesit. Një element i rëndësishëm në këtë kontribut është tërheqja e IJG-ve në sektorët kyç të ekonomisë (p.sh. Telekom, prodhimi i Hidro-energjisë, Ndërtimtari Prodhimtari, shërbime të TI, etj). **Në Maj të vitit 2010 Këshilli i Ministrave miratoi një vendim për ulje të Tatimit mbi Vlerën e Shtuar (TVSH) në sektorin e shëndetësisë dhe të teknologjisë së informacionit nga 20% në 10%.**

Faktorët themelorë kyç në zhvillimin e TIK në Shqipëri<sup>9</sup>:

- Telekomunikacioni ka qenë ndër aktivitetet më dinamike të shërbimeve në Shqipëri, duke u zhvilluar përmes privatizimit dhe investimeve pasuese të investitorëve të huaj dhe në një masë edhe me anë të investimeve të brendshme;
- Qeveria Shqiptare ka implementuar një numër reformash fiskale dhe legjislative për të përmirësuar klimën e biznesit për investitorët e huaj. Shqipëria ka aplikuar një kornizë të politikave të favorshme për investimet e huaja direkte, dhe kohët e fundit ka prezantuar politika për të mbështetur zhvillimin e sektorit privat në përgjithësi;
- Qeveria vlerëson rëndësinë e TIK dhe ka ndërmarrë veprime për të lehtësuar zhvillimin e sektorit dhe për të integruar TIK-un në qeverisje nëpërmjet një shumëllojshmërie të gjerë të veprimeve të TIK në sektorët e ndërlidhur;
- Anëtarët e komunitetit të biznesit të huaj gjithashtu presin që në të ardhmen qeveria Shqiptare të përmirësojë më tej klimën e biznesit duke thjeshtuar procedurat administrative, duke përmirësuar procedurat e licencimit dhe duke implementuar sundimin e ligjit.

Përveç kësaj, operacionet e mëposhtme janë krejtësisht të përjashtuara nga pagesa e TVSH-së:

- Arsimi;
- Furnizimi me shërbime financiare;
- Ari, furnizimet me bankënota ose monedha për Bankën e Shqipërisë;
- Furnizimi me pulla postare të përdorura për shërbimet e postës ose pullat e ngjashme;
- Furnizimet e ofruara nga një organizatë jofitimprurëse kundrejt pagesës së reduktuar konsiderohen si furnizime të përjashtuara bazuar në kushtet e përcaktuara në Nenin 24, etj.

---

<sup>9</sup> Burimi: UNDP, Raporti për Investimet e Jashtme Direkte. Shqipëri 2011, mund ta gjeni në:

<http://intra.undp.org.al/ext/elib/download/?id=1120&name=web%20fdi%20report%20english%2Epdf>



## B. IRJ E MAQEDONISË

Tregu Maqedonas i Teknologjisë së Informacionit kishte shënuar rritje të ndjeshme prej 7.7% në vitin 2009, duke arritur në 164.5 milionë \$<sup>10</sup>. Gjatë periudhës së parashikuar pesë-vjeçare, tregu i TI i këtij vendi pritet të rritet me një normë vjetore të rritjes (NVR) prej 5.2%, për të arritur në 212 milionë \$ në vitin 2014. Hardueri është segmenti më i madh dhe më dinamik i tregut Maqedonas të TI, me një rritje vjetore prej 84.7%, duke marrë rreth 62% të tregut të përgjithshëm të TI. Shërbimet e TI janë segmenti i dytë më i madh, i cili përbën 25.6% të totalit të shpenzimeve në TI, me një rritje prej 15.8% në vitin 2009, ndërsa pakot e softuerit janë në vendin e tretë me 13% të tregut të përgjithshëm, me një normë vjetore të rritjes prej 8.2%.

Kjo rritje është nxitur nga investimet e mëdha në TI nga ana e qeverisë dhe kompanive të telekomunikacionit, shpenzimet e vazhdueshme në sektorin financiar, nga rënia e çmimeve të pajisjeve të TI-së, dhe nga **ulja e TVSH-së për pajisjet -> nga 18% e TVSH-së së përgjithshme në 5%, e shkallëzuar vetëm për pajisjet e TIK.**

Maqedonia është vendi i parë në rajonin e BP që e ka këtë normë të veçantë të TVSH-së të zbatueshme vetëm për pajisjet e TIK. Përfitimet dhe rezultatet e gjeneruara brenda vendit dhe të ardhurat për Qeverinë konsiderohet se përparojnë mirë dhe kanë patur një ndikim të madh në zhvillimin e industrisë dhe në mundësitë për tregun e synuar.

## C. SERBIA

Me një rritje vjetore dyshifrore në vitet para krizës së vitit 2008, TIK<sup>11</sup> është ndër sektorët Serbë më të gjallë dhe me zhvillim më të shpejtë, që ilustron gjallërinë dhe rëndësinë e këtij sektori për vendin. Megjithatë, kriza ekonomike e goditi rëndë Serbinë, duke ndikuar negativisht edhe në industrinë e TIK-ut. Vlera e tregut Serb të TI me siguri do të qëndrojë e ngujuar në "tunel" në vlerat ndërmjet 400 milionë dhe 450 milionë Euro, për gati 5 vjet (2009-2013). **Që nga Dhjetori i vitit 2012 - TIK ka kontribuar me 6.1 % në BPV prej 29.5 miliardë € ose rreth 1.8 miliardë €.**

Norma aktuale e TVSH-së standarde në Serbi është 20%. Ekzistojnë dy norma të reduktuara prej 0% dhe 8%.

Norma e TVSH-së prej 0% zbatohet për:

- Eksportet nga Serbia nuk i nënshtrohen Tatimit mbi Vlerën e Shtuar;
- Të ardhurat nga shërbimet financiare, të tilla si sigurimi dhe shërbimet bankare, të ardhurat nga investimet, janë të përjashtuara nga TVSH-ja;
- Çdo biznes, qarkullimi vjetor i të cilit i kalon 4 milionë Dinarë<sup>12</sup> (35,145.78 Euro) në 12 muaj (ose kur pronarët e bizneseve në fillim të punës së tyre vlerësojnë se qarkullimi i biznesit do të kapërcejë atë shumë) bëhet tatimpagues i TVSH-së.

<sup>10</sup> Burimi: Investoni në Maqedoni – Industria e TIK

[http://www.investinmacedonia.com/sites/invest/files/content\\_resources/ICT%20Industry.pdf](http://www.investinmacedonia.com/sites/invest/files/content_resources/ICT%20Industry.pdf)

<sup>11</sup> Burimi: TIK në Serbi në një Vështrim - <http://www.scribd.com/doc/122764289/ICT-in-Serbia-at-a-Glance-2013>

<sup>12</sup> <http://www.xe.com/currencyconverter/convert/?Amount=4000000&From=RSD&To=EUR>



TVSH prej 8% paguhet për:

- Bukë, qumësht, miell, sheqer, lulediell ushqimor, misër, repë, sojë dhe vaj ulliri, kafshë të ngrënshme dhe yndyrna bimore; fruta dhe perime të freskëta dhe të ngrira, mish, peshk, dhe vezë;
- Barnat e përfshira në listën e barnave që shiten me recetë dhe të nxjerra nga fondet për sigurim shëndetësor, në pajtim me rregulloret e sigurimit shëndetësor; mjetet ortotike dhe protetike, si dhe produktet medicinale që implantohen në mënyrë kirurgjike; materialet për dializë;
- Plehrat, pesticidet, rezervat e farëve, rezervat e fidanishteve dhe përzierjet e gatshme të foragjereve për ushqimin e kafshëve;
- Tekstet mësimore dhe mjetet mësimore; gazetatat ditore; monografitë dhe botimet serike;
- Dru për ngrohje;
- Akomodimi në hotele, motele, vendpushime, qendra rekreative dhe kampe;
- Shërbimet komunale;
- Gazi natyror i dërguar prodhuesve individual nëpërmjet rrjetit të shpërndarjes së gazit.

Sektorët dhe shërbimet e mëposhtme janë të përjashtuar nga TVSH-ja:

- Shërbimet arsimore;
- Shërbimet mjekësore;
- Shërbimet kulturore;
- Dhuratat dhe donacionet bamirëse;
- Qiraja (kur përdoret vetëm për qëllime banimi);
- Shërbimet financiare të ofruara nga bankat dhe kompanitë e sigurimit;
- Toka;
- Shërbimet e organizimit të llotarive dhe lojrave të fatit.

## D. TURQIA

Tregu Turk i TIK është rritur në mënyrë eksponenciale me 14 për qind NVRN ndërmjet viteve 2002 dhe 2010, duke arritur në 28,5 miliardë dollarë në vitin 2010, dhe pritet të kalojë 30 miliardë dollarë në vitin 2011.

Norma standarde e TVSH-së është 18%. Ekziston edhe një normë e reduktuar prej 8% që aplikohet për: ushqimet bazë; produktet mjekësore; librat; dhe të tjera, dhe një normë super e reduktuar prej 1% që aplikohet për: produktet bujqësore; prona të caktuara të banimit; gazeta & revista, dhe të tjera.

Turqia, rregullisht aplikon të ashtuquajturat “Ulje të Përkohshme të Tatimit në Konsum” që kanë për synim kryesisht mallrat që konsumohen gjerësisht, të tilla si **TIK pajisjet**, veturat, etj. Kjo nxitje fiskale, përveç vjerash ka kontribuar në mënyrë direkte dhe indirekte në zhvillimin e saj të madh ekonomik në dekadën e fundit, në normën prej 6 – 8% në baza vjetore.

## V. Ndikimi Financiar në Buxhetin e Kosovës

Ndikimi i mundshëm financiar në buxhetin e Kosovës është ilustruar më poshtë bazuar në shifrat nga Administrata Tatimore (2012) dhe në vlerësimet e konsulentit për vitet 2014/15/16 – duke përdorur trendet e atij viti dhe parashikimet për rritje në sektorin e TIK dhe gjenerimin e prituri të të hyrave direkte dhe indirekte të brendshme për buxhetin e Kosovës përmes rritjes së konsumit dhe punësimit. Ato janë të bazuara në një ulje të TVSH-së për produktet dhe shërbimet e TIK nga 16% në 5% dhe 10%. Në periudhën afatmesme ndikimi do të ishte shumë-dimensional në kuptimin pozitiv, me rritje të burimeve të brendshme të të ardhurave tatimore për shkak të konsumit të brendshëm më të madh, gjenerimit të punësimit, aftësive të zhvilluara dhe IJD-ve në kompanitë dhe shërbimet e TIK (perspektiva afatmesme). Gjithashtu, kjo analizë përfshin qarkullimin e llogaritur prej qytetarëve të KS që konsumojnë/blejnë pajisje të TIK në MK-Shkup për shkak të çmimeve më të favorshme në vlerë prej 11% -20% (shih seksionin I më sipër, për detaje) kryesisht për shkak të shkallëzimit të TVSH-së së tyre, që ka filluar të aplikohet kohët e fundit.

Tabela e mëposhtme dhe kalkulimet pasqyrojnë ndikimin në buxhetin e Kosovës, bazuar në vlerësimet e thjeshta, duke marrë parasysh se përfitimet shtesë do të jenë evidente në perspektivën afatmesme, nëse fillon të aplikohet një shkallëzim i TVSH-së për pajisjet dhe shërbimet e TIK.

Viti	Perspektiva afat-shkurtër Zvogëlim i buxhetit		Perspektiva afatmesme Rritja e buxhetit	
	2012	2014 <sup>13</sup>	2015	2016
<b>Buxheti i Kosovës (Milion Euro) (a)</b>	1,500	1,500	1,650 (10% rritje)	1,815 (10% rritje)
<b>Të ardhurat nga TVSH-ja në buxhetin e Kosovës (Milion Euro)<sup>14</sup> (b)</b>	129,96	128,48	131,04 (128,48*20%)	134,31 (131,04*25%)
<b>Pjesëmarrja e TVSH-së në të hyrat totale të taksave në KS (%) ©</b>	45,78	45,25	49,75 (10% rritje)	54,72 (10% rritje)
<b>Pesha e vlerësuar e TIK në buxhetin e Kosovës (%) (d)</b>	1,00	1,50 (d*0.5)	2,00 (d*0.5)	2,50 (d*0.5)
<b>Implikimet buxhetore - perspektiva afatshkurtër 2012 (ulje e TVSH-së prej 11% - nga 16% në 5%) kundrejt Ndikimit pozitiv në të hyrat nga TVSH-ja – në periudhën afatmesme 2014/15/16 (Milion Euro) (e)</b>	(1,65)	2,47 (e*d)	2,56 (e*d)	2,68 (e*d)
<b>Shpenzimet nga përdoruesit individualë Kosovarë për pajisjet e TIK në MK-Shkup 2012 – humbja e TVSH-së prej 16% kundrejt Konsumit të brendshëm në Kosovë - TVSH në vlerë prej 5% - parashikimet për 2014/05/16 (Milion Euro) – Fitimi prej 5% nga TVSH-ja në vitet 2014/15/16 (f)</b>	(1,60) (20,000 PCs*500=10,00)	0,50 (20,000 PCs*500=10,00)	0,625 (25,000 PCs*500=12,50)	0,75 (30,000 PCs*500=15,00)

**Tabela 4:** Analiza e ndikimit financiar 2014-2016 (vlerësimet)

<sup>13</sup> E parashikuar me qëllim të krahasimit më të lehtë

<sup>14</sup> Raportet Vjetore të ATK-së - <http://www.atk-ks.org/publikime/raportet-vjetore/>

Siç është ilustruar më lartë, ndikimi është *pozitiv* në bazë të vlerësimeve të thjeshta, të cilat nuk kanë marrë parasysh variabla të tjera (p.sh. rritja e kontributeve nga tatimi në fitim i kompanive, nga skema e pensioneve, ulja e papunësisë, zvogëlimi i ekonomisë informale, etj). Prandaj, efektet pozitive do të ishin të *menjëhershme* brenda periudhës 1 (një) vjeçare (d.m.th. që nga 01/2015 nëse ulja e TVSH-së fillon me 01/2014), ndërsa përfitimet shumë-dimensionale për buxhetin e Kosovës do të kompensojnë humbjen simbolike gjatë vitit të parë – 2014.

Kështu, vetëm sipas kolonës së mësipërme (f) ndikimi pozitiv është për më shumë se 3,00 (tre) milionë Euro vetëm duke përdorur vlerësimet e thjeshta të konsumatorëve individualë (duke përjashtuar kompanitë/qeverinë) për periudhën 2014/15/16. Përveç kësaj, në qoftë se shtojmë rrjedhën aktuale të parave – vetëm humbjet nga TVSH-ja prej 1,60 milion Euro për vitin 2012, rezulton se përfitimet e përafërta afatmesme *vetëm nga konsumi individual* do të ishin rreth 5,00 (pesë) milion Euro për buxhetin e Kosovës për periudhën 2014/15/16 vetëm për TVSH, ndërsa efektet tjera pozitive indirekte do të ishin shumë-dimensionale.

## VI. Rekomandimet

**Bazuar në faktet** e mësipërme, **analizën dhe shqyrtimin e praktikave më të mira** nga vendet fqinje, rekomandohet që të ndërmerren masat e mëposhtme nga ana e Qeverisë:

### A. QË KANË TË BËJNË ME TVSH-NË

---

1. Qeveria e Kosovës duhet sa më parë të vazhdojë bisedimet me vendet e ndryshme (ato që e kanë njohur Kosovën) për nënshkrimin e **“marrëveshjeve për shmangien e tatimit të dyfishtë”**, duke i lejuar shumë kompanive që janë pjesë e të njëjtit grup ose që janë me seli në vende të ndryshme që të bëhen më konkurruese (d.m.th. duke mos faturuar TVSH-në për shërbimin ose mallin e furnizuar). Gjithashtu ky është edhe një stimulim tatimor për tërheqje të IJD-ve;
2. STIKK rekomandon aplikimin e një **norme të sheshtë prej 5% TVSH** (ulje nga 16%) të zbatueshme për **pajisjet e TIK** (harduerike dhe softuerike) duke amendamentuar Ligjin për TVSH-në që është aktualisht në fuqi (Ligji nr. 03/L-146); Kjo duhet kombinuar me lirim nga pagesa e doganës për të gjitha TIK pajisjet e importuara (kryesisht harduerike dhe softuerike);
3. STIKK rekomandon aplikimin e një **norme të sheshtë prej 5% TVSH** (ulje nga 16%) të aplikueshme për **shërbimet e ndërlidhura me TIK** duke amendamentuar Ligjin për TVSH-në që është aktualisht në fuqi (Ligji nr. 03/L-146);
4. Institucionet arsimore – si publike ashtu edhe ato private duhet të inkurajohen të blejnë dhe të shtojnë pajisjet e TIK-ut me **norma të reduktuara të TVSH-së dhe doganës, duke u ndihmuar atyre në krijimin e programeve dhe laboratoreve specifike për zgjerimin e aftësive dhe çertifikimit në lëminë e TIK;**



5. **Krijimi i një sistemi të kuponëve<sup>15</sup> për blerjen e kompjuterëve të ri** (desktopë dhe laptopë) të dedikuar për grupet e synuara specifike (p.sh. studentët e universiteteve ) të të gjitha shkollave të licencuara publike dhe private në Kosovë;
6. STIKK gjithashtu do të jetë në dispozicion dhe i gatshëm për të ndihmuar në krijimin e **një liste gjithëpërfshirëse të pajisjeve dhe shërbimeve të TIK** për të cilat do të vrente vendimi i Qeverisë për TVSH-në dhe/ose shkallëzimin apo uljen e taksave Doganore.

## **B. MASAT E POLITIKAVE FISKALE TË PËRGJITHSHME**

7. Qeveria e Kosovës me ndihmën e drejtpërdrejtë të STIKK-ut duhet të krijojë një Forum ose **Task Forcë Kombëtare të veçantë për TIK** (të përbërë nga ministritë kryesore të linjës, donatorët, agjencitë, institucionet arsimore, kompanitë publike dhe private, shoqatat, etj.) në mënyrë që të përcaktohen prioritetet e potencialit që kompanitë e Kosovës dhe popullata e saj e re kanë në fushën e TIK-ut;
8. Krijimi i një **Grupi Kombëtar për Reformën e Politikave Fiskale** (Ministritë e Linjës, Donatorët, Sektori Privat, Akademitë, Shoqëria Civile, partnerët Socialë) në mënyrë që të zgjerohet/koordinohet/krijohet një pako fiskale stimuluese (duke përfshirë uljen e TVSH-së) të shënjestruar kryesisht në tërheqjen e IJDeve;
9. **Ministria e Arsimit dhe Agjencia e saj e Akreditimit** duhet të adresojnë nevojën për **trajnime dhe çertifikime të veçanta** të cilat janë të pranuar ndërkombëtarisht, duke i bërë studentët e rinj të Kosovës të aftë për të konkurruar në skenën rajonale dhe ndërkombëtare në aspektin e mundësive të punësimit; STIKK do të ketë kënaqësinë **të ndihmojë me resurset e saj** dhe me kompanitë anëtare në këto përpjekje;
10. Gjithashtu rekomandohet që disa shërbime me tatim mbi vlerë të shtuar që kanë potencial për rritje dhe punësim (p.sh. shërbime profesionale, të tilla si shërbime **juridike, të kontabilitetit, auditimit, shërbime inxhinieriike, arkitektonike, të shtypjes dhe botimit**, etj.) gjithashtu të përfshihen në shkallëzimin e TVSH-së prej 10% - ngjashëm me shërbimet e TIK;
11. Shkalla e TVSH-së prej 5% duhet të futet edhe për **“pakon bazë ushqimore”** të përmendur më parë (seksioni II) – për përbërësit dhe produktet përfundimtare;
12. STIKK do të jetë në dispozicion për të ndihmuar Qeverinë e Republikës së Kosovës në ndarjen e praktikave më të mira dhe modeleve të përdorura nga industria e TIK-ut, duke synuar përmirësimin e klimës së biznesit në Kosovë, të cilat mund të zbatohen edhe në disa sektorë të tjerë, të tillë si shërbimet profesionale, etj.

---

<sup>15</sup> Detajet duhet të jenë të përshtatura sipas një procedure të veçantë të centralizuar – STIKK do të dalin vullnetarë për të ndihmuar në procesin e projektimit dhe monitorimit duke përdorur praktikën më të mira.

Rr. Rexhep Mala, 28A

10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

Tel. **+381 38 77 11 80** ext. **501**

**info@stikk-ks.org ; www.stikk-ks.org**



[/STIKK.Official](#)



[/STIKK\\_Ks](#)



[/company/STIKK](#)